



# BULETINI

DHJETOR 2023



Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor



*Gëzuar  
Festat e  
Fundvitit!*



## Takim mes ASIG dhe përfaqësuesve të International Telecommunication Union

ASIG ka zhvilluar takimin me përfaqësues të International Telecommunication Union, i cili synonte shqyrtimin e mundësive të bashkëpunimit rreth përmirësimit të BroadBand Mapping në Republikën e Shqipërisë. Në takim ishin të pranishëm edhe ekspertë të ASIG të cilët diskutuan mbi mundësitë e zhvillimit të projekteve të ndryshme për gjeoinformacionin të cilat mund të ndikojnë në sektorin e telekomunikacionit.



## Llogaritja e gjeoidit gravimetrik në Republikën e Shqipërisë



ASIG në funksion të realizimit të objektivave të tij për ndërtimin e rrjeteve përbërëse të Kornizës Referuese Gjeodezike Shqiptare (KRGJSH), në kuadër të projektit "Ndërtimi i Kornizës Referuese Gjeodezike, FAZA III", zhvilloi një takim me ekspertë të fushës së gravimetrisë dhe gjeoidit, nga Universiteti Aristotle i Selanikut (AUTH), Greqi. Ekspertët e ASIG nga Sektori i Kornizës Referuese Gjeodezike, Drejtoria e Gjeodezisë dhe Hartografisë diskutuan me profesorët e AUTH situatën aktuale të të dhënave gravimetrike, teknikat e llogaritjes dhe vlerësimit të gjeoidit sipas metodave bashkëkohore, dhe realizimin e matjeve gravimetrike relative, për rrjetin e rendit të II-të, me qëllim llogaritjen e gjeoidit gravimetrik "ALB-Geoid23.v1".

## Takim mes ASIG dhe pedagogëve të

### Departamentit të Gjeodezisë

ASIG realizoi takimin mes përfaqësuesve të tij të kryesuar nga Drejtori i Përgjithshëm znj. Vilma Tomço dhe një grupi akademikësh të Departamentit të Gjeodezisë, në Fakultetin të Inxhinierisë së Ndërtimit, të Universitetit Politeknik të Tiranës, në funksion të realizimit të doktoraturave, të cilat kanë të bëjnë me Referencat Gjeodezike Horizontale dhe Vertikale. Gjatë këtij takimi u diskutua situata aktuale e rrjeteve përbërëse të KRGJSH-së, si dhe njohja me realizimin për herë të parë në Republikën e Shqipërisë të llogaritjes së gjeodit gravimetrik "ALB-Geoid23.v1".



## Praktikë mësimore në ASIG



Një grup studentësh të vitit të parë Master Profesional, profili Gjeomatikë, Fakulteti i Gjeologji Minerave të Universitetit Politeknik të Tiranës, zhvilluan një seancë praktike mësimore në ambientet e ASIG. Ekspertët e Sektorit të Fotogrametrisë të ASIG i njohën studentët me teknologjinë që disponon për rielimin fotogrametrik 3Dimensional, u shpjeguan atyre hapat që duhen të ndiqen për krijim e një projekti Fotogrametrik, teknikat e rielimit Fotogrametrik 3 Dimensional dhe rielimi me metodën Niveli 2 i detajeve (level of details 2, LOD2).

## **BOTA E GJEONFORMACIONIT**

### Inteligjenca artificiale identifikon retë e metanit nga hapësira me anë të përpunimit të imazheve hiperspektrale

Studiuesit e Universitetit të Oksfordit, në partneritet me NIO.space të Trillium Technologies, kanë zhvilluar një mjet për të zbuluar automatikisht retë e metanit në Tokë nga orbita duke përdorur Machine Learning me të dhëna hiperspektrale. Kjo do të ndihmojë në identifikimin e "super emetuesve" të tepruar të metanit dhe të mundësojë veprime më efektive për të reduktuar emetimet e gazrave në serra.

### Bashkëpunimi TOPODRONE-GROWING synon avancimin e hartës termike me dron

TOPODRONE në vijim të punës kërkimore shkencore solli një zgjidhje të re të hartës termike të dronëve. Kamera TOPODRONE PT61 mundëson kryerjen e vëzhgimeve të hollësishme dhe prodhimin e hartave termike ortomozaike duke marrë modele të sakta 3D. Zgjidhja e re fotogrametrike u zhvillua në bashkëpunim me AGROWING me kërkesë të një klienti të ndërmarrjeve të mëdha nga Amerika e Veriut dhe më vonë është përshtatur për një përdorim më të gjerë të topografëve me dron.

### International Conference on Satellite Imagery and GIS Geography (ICSIGISG)

Kjo konferencë është një mundësi e shkëlqyer për të përmirësuar aftësitë, për të fituar njohuri dhe për të takuar ekspertë në lidhje me Shkencën e Tokës dhe gjithashtu synon të diskutojë të gjitha idetë e reja, skenarët aktualë dhe zgjidhjet. Për më tepër, do të nxisë karrierën tuaj dhe do t'ju ndihmojë të eksploroni fusha të reja.

11-12 Janar 2024

[www.asig.gov.al](http://www.asig.gov.al)

Rruga Papa Gjon Pali II Nd. 2, H. 3, 1010, Tiranë;

## **AKTIVITETE NË VIJIM**



### Workshop on Sustainable Business Models for NMCAS

EuroSDR dhe EuroGeographics ftojnë NMCA-të, studiuesit dhe politikëbërësit të paraqesin, diskutojnë dhe ndajnë përvojat e tyre gjatë një seminari të dedikuar në muajin shkurt 2024. Ky aktivitet synon të sigurojë një inventar të modeleve të biznesit të cilat NMCA-të i kanë zbatuar, janë duke i zbatuar ose do të planifikojnë t'i zbatojnë për t'ju përshtatur, për të përfunduar detyrat e tyre.

8-9 Shkurt 2024

[www.geoportal.asig.gov.al](http://www.geoportal.asig.gov.al)

Telefon: +355 (0)42 223 762;

E-mail: [info@asig.gov.al](mailto:info@asig.gov.al);